



Rama: Kemi hequr mundësinë që nafta në bujqësi të abuzohet

Faqe 4



Salla: Fermerët do të përfitojnë mbështetje 10% të faturimit të tyre

Faqe 2



"Mbrotjtja e konsumatorëve, thelbësore për integrimin" - Reforma e inspektimeve, Sula: Ligji është përafuar me BE

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit prill 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 531
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

NJË INVESTIM AFATGJATË PËR MBROJTJEN E PRODHIMIT DHE FORCIMIN E KONTROLLIT FITOSANITAR

UNIDO DHE ZVICRA MBËSHTESIN ISUV ME EKSPERTIZË NDËRKOMBËTARE PËR RRITJE TË BESUESHMËRISË NË DIAGNOSTIKËN FITOSANITARE NË SHQIPËRI


Në një bujqësi të ekspozuar ndaj rreziqeve fitosanitare, laboratorët janë kyç për zbulimin dhe diagnostikimin e saktë të sëmundjeve, në përputhje me standardet SPS. Në këtë kuadër, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial dhe qeveria zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike kanë mbështetur ISUV me trajnime të specializuara, duke forcuar kapacitetet laboratorike dhe përafuar praktikën me standardet europiane

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Ministri Salla në Kavajë: Shqipëria nis eksportin e vezëve "Kategoria A", pas dakordësimit me BE



Faqe 5

POLITIKË FISKALE

Fond 100 mln lekë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme



Faqe 5

FINANCIM

Skema kombëtare 2026, grant 10 mijë euro për fermerët e rinj



Faqe 2

KËNDI I EKSPERTIT



Enver Isufi: Mendimi tredimensional dhe përtej tij, në shkencë, prodhim, letërsi

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrotjtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- Afta Epizootike në Greqi, Shërbimi Veterinar në Gjirokastrë shton kontrollet në territor Fq.5
- Ankohemi për naftën, por ka mbërritur dhe kriza e domates, kalon 400 lekë/kg Fq.6
- Kompensimi i TVSH-së për fermerët, si do të llogaritet me autofaturat Fq.7
- Kërpudhat në Krahinën e Oparit - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

SUBVENCIONE

Salla: 330 mijë tonë eksporte bujqësore, fokus te rritja e investimeve dhe cilësisë

Rritja e eksporteve bujqësore po konsolidohet si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave të familjeve fermere dhe fuqiz-

itjen e investimeve dhe rritjen e prodhimit vendas.

Duke sjellë një shembull konkret nga terreni, Salla përmendi zhvillimet në fshatin Hoxhaj, ku sipërfaqja me serra që aplikojnë mbrojtjen

financiare për fermerët dhe agrobizneset.

“Po zgjerojmë mbështetjen për bujqësinë, veçanërisht për të rinjtë, për të nxitur investime të reja dhe për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit. Synojmë përdorimin e teknologjive të avancuara në prodhim, përmirësimin e cilësisë sipas standardeve të BE-së dhe zbatimin e praktikave që garantojnë mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë ushqimore”, u shpreh ministri.

Ai shtoi se këto politika synojnë jo vetëm rritjen e eksporteve, por edhe zgjerimin e pranishë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, duke krijuar mundësi shtesë për fermerët dhe agrobizneset.

Gjithashtu, ministri vuri në dukje rëndësinë e përmirësimit të aksesit në financim dhe të infrastrukturës bujqësore, si element kyç për përbalimin e sfidave të tregut dhe rritjen e qëndrueshme të sektorit.

“Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen ndaj fermerëve, me synimin për ta kthyer bujqësinë në një sektor gjithnjë e më konkurrues dhe të orientuar drejt eksportit”, u shpreh Salla.



imin e sektorit rural.

Në një konferencë për mediet në Tiranë, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, në interes të pyetjes së ATSH-së mbi impaktin e instrumentave mbështetës në rritjen e prodhimit dhe eksporteve, bëri të ditur se gjatë vitit të kaluar eksportet bujqësore arritën në 330 mijë tonë.

Ministri theksoi se skema kombëtare e mbështetjes vijon të jetë gjithëpërfshirëse, me fokus të veçantë në nx-

biologjike është rritur nga 40, në 55 hektarë brenda 6 muajve. “Mbështetja që kemi vendosur, në nivelin 70% të koston për procedurat e mbrojtjes biologjike, do të vijojë, duke ulur kostot e prodhimit dhe duke rritur prodhimin cilësor”, deklaroi ministri.

Salla theksoi se kjo është një skemë gjithëpërfshirëse që synon afrimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe që do të konsolidohet përmes rritjes së mbështetjes

Salla: Fermerët do të përfitojnë mbështetje 10% të faturimit të tyre

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla deklaroi se skema e naftës mbështet uljen e koston së fermerëve.

Në një konferencë për shtyp me gazetarët, Salla tha se ndër vite skema e mbështetjes së fermerëve, ka qenë nga dhënia e naftës drejtpërdrejt, te mbështetja me fonde.

“Ne kemi kaluar në mbështetje me pagesë për uljen e kostove, sipas standardeve të BE-së. Ne do ta mbulojmë edhe në vitin 2026 dhe është një nga skemat që është diskutuar me shumë edhe nga mediet. Skema e naftës është një skemë mbështetëse për uljen e koston dhe ne kemi menduar që çdo fermer të bëhet pjesë për përfitimin e masave që ne kemi vendosur, por kjo është në masën 10% të faturimit të tyre”, tha Salla.

Ministri Salla deklaroi se bëhet fjalë për një skemë gjithëpërfshirëse, duke pasur parasysh BE-në, pasi edhe fermerët që do të bëhen pjesë e tregut të BE-së duhet të konkurrojnë me cilësi.

“Qeveria po bën punën e saj për të përgatitur legjislacionin për BE-në dhe për të përbushur detyrimet në kapi-tujt përkatës, por edhe fermeri

turimit që do të marrë pas dërgimit të faturave të Tatimet çdo 6 muaj.

“Nuk është vetëm një masë naftë, është mbështetje për



duhet të jetë pjesë e kësaj skeme për të qenë pjesë e BE-së. Fondin 4,6 miliardë euro e kemi çuar në 5,2 miliardë euro si mbështetje nga buxheti i shtetit, si masë për uljen e koston së prodhimit, por kjo është dhënie pagese që fermeri të ulë kostot”, tha Salla.

Salla tha se fermeri bëhet pjesë në të gjitha masat e skemës, krahas 10% të fa-

fermerin dhe këto janë masat që kemi vendosur”, tha ai.

I pyetur nga gazetarët në lidhje me vizitën në Bruksel për zhbllokimin e fondeve të IPARD nga BE, Salla tha se ka pasur një takim me ekipin në Bruksel dhe deri në 9 prill është caktuar afati që të depozitohen kërkesat e kërkuara nga BE me synim për të akredituar paketën e IPARD-it.

“Mbrojtja e konsumatorëve, thelbësore për integrimin” - Reforma e inspektimeve, Salla: Ligji është përafuar me BE

Inspektori i Përgjithshëm, Dashnor Sula, ka zhvilluar një tryezë me inspektoratet e varësisë. Në fjalën e tij, Sula tha se synohet përmirësimi i standardeve të kontrollit dhe mbrojtja e konsumatorit, si element të rëndësishëm për procesin e integritimit.

“Përmirësimi i standardeve dhe mbrojtja e konsumatorëve thelbësor për përbushjen e kushteve të BE.

Reforma e sistemit të inspektimit, e rëndësishme për burime njerëzore cilësore dhe për të forcuar kontrollin e standardeve në vend.

Kur sistemi i inspektimit funksionon mirë, rritet besimi të institucionet, garantohej siguria dhe mbrohen të drejtat e qytetarëve.

Kur nuk funksionon sistemi sipas standardeve, dëmtohet besimi, krijohet hapësira për informalitet, abuzim dhe rrezik për interesin publik. Kjo vendos përgjegjësi mbi ne si trupë inspektuese. Ligji është kryesisht i përafuar me BE, problem është zbatimi real dhe i njëtrajtshëm i ligjit. Ligji i ri për inspektimin vendos një standard të ri për funksionimin e sistemit të kontrollit publik në vend, krijon kornizë

të qartë përgjithësisht metodologjinë dhe transparencën në aktivitetin inspektues”, tha Sula.

Sula shtoi se reforma synon transformimin nga një sistem i fragmentuar drejt një sistemi me standarde të unifikuara.

Sula përmbylli ciklin e takimeve me institucionet e varësisë, të cilët i ka këshilluar të bëjnë me integritet punën e tyre dhe të zbatojnë ligjin.



Skema kombëtare 2026, grant 10 mijë euro për fermerët e rinj

Qeveria shqiptare miratoi skemën kombëtare mbështetëse për fermerët për vitin 2026, duke synuar mbështetjen e investimeve bujqësore në të gjithë vendin.

fermerët e rinj, do të hapen thirrje për grant prej 10 mijë eurosh, kryesisht në sektorin e blegtorisë.

Sa i përket ndërtimit të staneve për blegtorët, Salla tha se

rritjes së derrat. Është një masë e re që kanë adresuar fermerët në skemën e re kombëtare. Përgjysmohen pragjet e përfitimit, pra përfitojnë fermat me 5 lopë, me 50 krerë të imëta me 25 koshere dhe me 5 dosa”, tha ai.

Salla tha se “për kontrollin biologjik të dëmtuesve në serra rritet mbështetja me 70% të koston së shpenzimeve. Pra, mbrojtja biologjike ka prioritet me mënyrën si ne sot kemi ndërtuar serrat me mbrojtjen biologjike, ku kemi një numër të konsiderueshëm të serrave biologjike, por duam që kjo masë të shtohet nga fermerët”.

Ministri bëri me dije se edhe sektori i rritjes së peshkut në ujërat e brendshme do të mbështetet, duke rikthyer masën për blerje rasati në ujërat e ëmbla.

“Subjekti i rritjes së peshkut në ujërat e brendshme do të mbështetet dhe kjo masë e cila është për blerje rasati në ujërat e ëmbla, të cilat ne kemi në territor dhe është një masë që mendojmë se është në rifutjen në këtë skemë që kemi”, tha ai.

Ai shtoi se për fermat mbi 3 hektarë, përfitimi do të jetë 10 mijë lekë për çdo hektar të mbjellë.

Po ashtu, sipas Sallës, këtë vit shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor do të mbështeten 100%, teksa shtoi se do të vijojnë që të ketë prioritet mbështetja e fermave me prodhim organik të certifikuar.

“Pra është një konsolidim në të gjitha fushat për të mbështetur skemën e re kombëtare në 2026-ën”, u shpreh ai.



Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë një konference për mediet, tha se skema është ndërtuar pas një procesi të gjerë konsultimi me fermerët në të gjithë territorin.

“Është një skemë që ne e kemi konsoliduar së bashku me fermerët në të gjithë territorin, kemi pasur një dëgjese me ta, 23 takime në 12 qarqe të Shqipërisë dhe kemi vendosur së bashku me stafin se kush janë pikat, për atë që kemi dëgjuar realisht nga fermerët, duke e përshtatur atë me buxhetin e akorduar nga qeveria shqiptare”, tha ai.

Salla sqaroi se mbështetja përfshin investime në serra, pemë frutorë, vreshta, stalla, mekanikë bujqësore, linja për përpunimin e produkteve, akuakulturë detare dhe agroturizëm.

Ai bëri të ditur se për

“do të ketë një grant diku tek 3 milionë lekë”, teksa shtoi se “për pajisje makineri bujqësore do të mbështeten me grant 500 mijë lekë, ku përfshihen të gjithë tankerat për ruajtjen e qumështit dhe vajin e ullirit”.

Salla tha se prioritete do të ketë edhe në blegtori.

“Në gjedhë nga 10 mijë lekë në 12 mijë lekë. Për të imtat nga 1200 lekë në 1500 lekë. Ku dyfishohet për bletë nga 1000 lekë në 2000 lekë. Në kemi një numër rreth 600 mijë koshere duam ta shtojmë këtë numër që ta çojmë në vitin 2027 në 1 milion”, tha ai.

Sipas Sallës, për herë të parë fermerët që rrisin derrat do të marrin 7 mijë lekë, ndërsa pragjet e përfitimit janë përgjysmuar.

“Për herë të parë i japim 7 mijë lekë për dosën në sektorin e

NJË INVESTIM AFATGJATË PËR MBROJTJEN E PRODHIMIT DHE FORCIMIN E KONTROLLIT FITOSANITAR

UNIDO DHE ZVICRA MBËSHTESIN ISUV ME EKSPERTIZË NDËRKOMBËTARE PËR RITJE TË BESUESHMËRISË NË DIAGNOSTIKËN FITOSANITARE NË SHQIPËRI

Në një bujqësi të ekspozuar ndaj rreziqeve fitosanitare, laboratorët janë kyç për zbulimin dhe diagnostikimin e saktë të sëmundjeve, në përputhje me standardet SPS. Në këtë kuadër, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial dhe qeveria zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike kanë mbështetur ISUV me trajnime të specializuara, duke forcuar kapacitetet laboratorike dhe përafruar praktikën me standardet europiane

Në një bujqësi gjithnjë e më të ekspozuar ndaj rreziqeve fitosanitare, mbrojtja e prodhimit nuk varet më vetëm nga puna në terren. Ajo varet gjithnjë e më shumë edhe nga aftësia për të zbuluar në kohë, për të identifikuar saktë dhe për të konfirmuar me besueshmëri praninë e sëmundjeve dhe dëmtuesve që mund të kërcënojnë kulturat bujqësore. Në këtë realitet të ri, laboratorët nuk janë më vetëm struktura mbështetëse teknike, por një hallkë thelbësore e sistemit të mbrojtjes së bimëve dhe e reagimit institucional.

Ndryshimet klimatike, lëvizja më e madhe e materialit bimor, intensifikimi i tregtisë dhe shfaqja e rreziqeve të reja për bimët po e bëjnë diagnostikën fitosanitare gjithnjë e më të rëndësishme për sektorin bujqësor. Sa më i hershëm dhe më i saktë të jetë diagnostikimi, aq më e madhe është mundësia për të parandaluar përhapjen e rrezikut, për të mbrojtur prodhimin dhe për të mbështetur vendim-marrje më të sigurt nga institucionet përgjegjëse. Kjo qasje është në përputhje edhe me logjikën e sistemeve moderne të kontrollit fitosanitar dhe me kërkesat që lidhen me masat sanitare dhe fitosanitare (SPS), ku laboratorët luajnë një rol kyç në survejancë, kontroll zyrtar dhe menaxhimin e rrezikut.

Në këtë kuadër, **Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO)** dhe **qeveria Zvicerane** nëpërmjet SECO ka mbështetur Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (**ISUV**) përmes një serie trajnimesh të specializuara praktike me ekspertë ndërkombëtarë, në katër fusha kyçe të diagnostikës fitosanitare: **bakteriologji, virologji, nematologji dhe entomologji**. Këto aktivitete kanë ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të laboratorëve të shëndetit të bimëve dhe në përmirësimin e praktikave diagnostikuese drejt qasjeve më të harmonizuara, më të dokumentuara dhe më të besueshme, në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare, përfshirë praktikën e laboratorëve referencë në Bashkimin Europian.

Pse ka rëndësi kjo për bujqësinë shqiptare?

Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve përbëjnë një nga rreziqet më serioze për prodhimin bujqësor. Në shumë raste, ndikimi i tyre nuk matet vetëm me humbjen e rendimentit, por edhe me dëmtimin e cilësisë së prodhimit, rritjen e kostove për fermerin, përhapjen e rrezikut në zona të tjera dhe vështirësitë që krijohen për kontrollin dhe menaxhimin e situatës. Sa më vonë të identifikohet problemi, aq më të mëdha bëhen pasojat për prodhuesin dhe për vetë sistemin e mbrojtjes së bimëve.

Pikërisht për këtë arsye, laboratorët që mbështesin sistemin fitosanitar kanë sot një rol shumë më të rëndësishëm sesa thjesht analiza teknike. Ata janë një hallkë kritike në mbrojtjen e prodhimit bujqësor, sepse ndihmojnë në zbulimin e hershëm të rrezikut dhe në konfirmimin e saktë të pranisë së organizmave të dëmshëm. Kur diagnostikimi bëhet në kohë, me metoda të vlefshme dhe të dokumentuara mirë, reagimi bëhet më i shpejtë, kontrolli më efektiv dhe menaxhimi i rrezikut më i sigurt.

Në këtë kuptim, forcimi i kapaciteteve laboratorike nuk është vetëm një çështje teknike. Ai është një investim i drejtpërdrejtë në sigurinë e prodhimit, në mbrojtjen e fermerit dhe në rritjen e besueshmërisë së sistemit fitosanitar shqiptar.

Bakteriologjia: forcim i diagnostikës për Xylella fastidiosa

Një nga trajnimet e para të zhvilluara në këtë kuadër ishte trajnimi praktik 10-ditor i fokusuar në forcimin e kapaciteteve për validimin e metodës diagnostikuese për Xylella fastidiosa, një bakter me rëndësi të lartë fitosanitare, i njohur



për ndikimin që mund të ketë në kultura të ndryshme me interes ekonomik dhe për nevojën që paraqet për zbulim të hershëm dhe kontroll të besueshëm. Trajnimi u realizua me mbështetjen e një eksperti ndërkombëtar nga CIHEAM Bari, një institucion me eksperiencë të njohur në fushën e shëndetit të bimëve dhe diagnostikës fitosanitare. Gjatë këtij aktiviteti, stafi i laboratorit u përfshi në të gjithë rrjedhën diagnostikuese, duke nisur nga kuadri rregullator dhe standardet e aplikueshme, e deri te marrja dhe menaxhimi i mostrave, përgatitja e materialit bimor, nxjerrja e ADN-së dhe analiza molekulare përmes real-time PCR. Trajnimi përfshiu gjithashtu elemente kyçe si përdorimi i materialeve referencë, interpretimi i rezultateve, kontrolli i kontaminimit, gjurmueshmëria dhe dokumentimi i procesit analitik.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe kërkesave të menaxhimit të cilësisë në përputhje me ISO/IEC 17025, si dhe parimeve të validimit të metodës, përfshirë vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe riprodhueshmërisë së saj në kushtet e laboratorit. Ky aktivitet ka ndihmuar jo vetëm në forcimin e kapaciteteve teknike të stafit, por edhe në përmirësimin e mënyrës se si dokumentohet, strukturohet dhe standardizohet puna laboratorike, duke krijuar një bazë më të fortë për praktika diagnostikuese më të harmonizuara dhe më të besueshme.

Virologjia: më shumë gatishmëri përballë virozave me ndikim të lartë



Në fushën e virologjisë, mbështetja është fokusuar në forcimin e kapaciteteve për zbulimin dhe identifikimin e Tomato brown rugose fruit virus (ToBRFV), një virus me rëndësi në rritje për shëndetin e bimëve, që përbën kërcënim serioz për prodhimin e domates dhe specit.

Në këtë kuadër, në ISUV u zhvillua një trajnim praktik 10-ditor, i realizuar me kontributin e një eksperteje ndërkombëtare nga HAPIH, Kroaci, një institucion me ekspertizë në diagnostikë laboratorike dhe shëndet të bimëve. Gjatë aktivitetit, stafi i laboratorit punoi mbi aspektet kryesore të diagnostikës së virusit, duke përfshirë përgatitjen dhe trajtimin e mostrave, nxjerrjen e ARN-së, përdorimin e metodave molekulare si RT-PCR dhe real-time RT-PCR, si dhe interpretimin dhe verifikimin e rezultateve.

Trajnimi trajtoi gjithashtu çështje të rëndësishme që lidhen me biosigurinë, kontrollin e kontaminimit, dokumentimin e procesit analitik dhe elementët bazë të menaxhimit të cilësisë në laborator. Në një kohë kur lëvizja e materialit mbjellës, tregtia dhe ndryshimet klimatike rrisin ekspozimin ndaj virozave dhe rreziqeve të reja për kulturat bujqësore, forcimi i diagnostikës virologjike përbën një investim me rëndësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e prodhimit vendas

dhe për rritjen e gatishmërisë së sistemit fitosanitar.

Nematologjia: më shumë saktësi në identifikimin e rreziqeve në tokë



Një tjetër komponent i rëndësishëm i mbështetjes ka qenë edhe fusha e nematologjisë, me fokus në identifikimin e Globodera pallida dhe Globodera rostochiensis, dy organizma me rëndësi të lartë fitosanitare, të njohur për ndikimin që mund të kenë sidomos në kulturat e patates.

Në këtë kuadër, në ISUV u zhvillua një proces trajnimi i strukturuar në dy faza

plotësuese, që përfshiu si diagnostikën morfologjike, ashtu edhe atë molekulare, me mbështetjen e një eksperteje ndërkombëtare nga CREA, Itali, një institucion kërkimor me eksperiencë të njohur në fushën e bujqësisë dhe mbrojtjes së bimëve. Në total, mbështetja praktike në këtë fushë përfshiu 10 ditë trajnim intensiv, duke i dhënë stafit të laboratorit mundësinë të punojë në mënyrë të thelluar mbi fazat kryesore të procesit diagnostik.

Gjatë fazës morfologjike, stafi i ISUV punoi mbi përgatitjen e mostrave të tokës, nxjerrjen e nematodave, përgatitjen e preparateve, identifikimin e karakteristikave morfologjike dhe interpretimin e rezultateve. Në vijim, faza molekulare ndihmoi në forcimin e kapaciteteve për përdorimin e teknikave laboratorike që mbështesin konfirmimin më të saktë të identitetit të organizmave të analizuar, duke e bërë procesin diagnostik më të plotë dhe më të besueshëm.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjithashtu dokumentacionit teknik, gjurmueshmërisë dhe diskutimit të kërkesave që lidhen me verifikimin dhe validimin e metodave, në përputhje me protokollet e EPPO-s dhe me praktikën që ndiqen nga laboratorët që synojnë të forcojnë më tej sistemin e tyre të cilësisë. Ky trajnim ndihmoi jo vetëm në rritjen e kapaciteteve teknike të stafit, por edhe në evidencimin e disa nevojave konkrete laboratorike, veçanërisht në lidhje me pajisjet dhe mjetet bazë për analizat morfologjike. Kjo ka ndihmuar në krijimin e një pamjeje më të qartë jo vetëm për kapacitetet ekzistuese, por edhe për hapat e mëtejshëm që nevojiten për forcimin e kësaj fushe.

Entomologjia: identifikim më i mirë i dëmtuesve me rëndësi ekonomike

Në vijim të këtij procesi, UNIDO ka mbështetur edhe trajnimin në entomologji, një fushë kyçe për identifikimin e insekteve me rëndësi fitosanitare dhe ekonomike për bujqësinë.

Në këtë kuadër, në ISUV u zhvillua një proces trajnimi i strukturuar në dy faza plotësuese, që përfshiu si diagnostikën morfologjike, ashtu edhe atë molekulare, me mbështetjen e një eksperti ndërkombëtar nga CREA, Itali, një institucion kërkimor me eksperiencë të njohur në fushën e bujqësisë dhe mbrojtjes së bimëve. Në total, mbështetja praktike në këtë fushë përfshiu 10 ditë trajnim intensiv, duke i dhënë stafit të laboratorit mundësinë të punojë në

TEMA TË DITËS

Rama: Kemi hequr mundësinë që nafta në bujqësi të abuzohet

Kryeministri Edi Rama deklaroi se qeveria ka hequr mundësinë e abuzimit me skemën e naftës në bujqësi, duke theksuar se mbështetja vijon për fermerët që realisht prodhojnë, por jo për përdorime jashtë sektorit. Gjatë një takimi në Berat me sipërmarrës të përpunimit të vajit

ndryshimi i skemës synon orientimin e fondeve drejt atyre që punojnë dhe prodhojnë realisht, duke shtuar se çdo mbështetje duhet të kthehet në vlerë të shtuar përmes mekanizmave si rimbursimi i TVSH-së në masën 10%. Ai solli në vëmendje edhe rastet kur përfitimet për naftën mer-

dhimit bujqësor dhe se ndryshimet e ndërmarra nuk pritet të sjellin ulje të tij. Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e formalizimit në bujqësi, si një kusht kyç për përfitimin e mbështetjes shtetërore dhe aksesin në fondet e Bashkimit Evropian.

Në kuadër të zhvillimit të sektorit të vajit të ullirit, Rama

bashkëpunim më të madh mes prodhuesve, si dhe përmirësim të mënyrës së grumbullimit, paketimit dhe promovimit të produktit.

Kryeministri u ndal edhe te sfida e sigurisë ushqimore, duke e cilësuar atë si një element thelbësor në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Ai theksoi se nuk mund të ketë kompromis në këtë drejtim dhe u bëri thirrje sipërmarrësve të investojnë për përbushjen e standardeve të kërkuara.

Sipas Ramës, në rast të anëtarësimit në BE, produktet që nuk përbushin standardet nuk do të mund të tregtohen as në tregun vendas. Ai informoi gjithashtu se një mision inspektimi nga BE ka evidentuar rreth 900 pika në sektorin e produkteve me origjinë shtazore, duke dhënë rekomandime për përmirësime, investime ose përjashtim nga aktiviteti për subjektet që nuk arrijnë standardet.

Në përfundim, Rama theksoi se përshtatja me kërkesat e BE-së është e domosdoshme dhe se prodhuesit duhet të nisin që tani investimet dhe përgatitjet për të garantuar cilësi dhe siguri ushqimore, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare.

Pyjet “transformohen” në biznes, gati drafti për një kompani shtetërore, nga do vijnë të ardhurat

Qeveria ka propozuar krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, një kompani 100 për qind shtetërore që do të marrë në administrim fondin pyjor të vendit duke u larguar nga panorama që kemi sot.

Ky model i ri synon të rrisë eficiencën dhe transparencën në menaxhimin e pyjeve, duke kaluar nga një sistem fragmentarizuar institucional në një strukturë të vetme. Ministria e Mjedisit nxori për konsultim draft ligjin “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve” i cili parashikon pikërisht këtë nismë.

“Nevoja për këtë ndërhyrje lidhet ngushtësisht me sfidat aktuale të sektorit pyjor, si dhe me domosdoshmërinë për të ndërtuar një model të qëndrueshëm, efikas dhe transparent të menaxhimit të këtyre burimeve natyrore” thuhet në relaciori.

Kapitali fillestar i propozuar është 50 milionë lekë, ndërsa të ardhurat e kompanisë pritet të vijnë nga shitja e drurit, produkteve jo-drusore, bimëve medicinale dhe hyrja në tregjet globale të krediteve të karbonit (një segment në rritje në botë që gjeneron të ardhura).

Pasuritë pyjore shtetërore do të transferohen për ad-

ministrim tek kompania, pa ndryshuar pronësinë publike. Përmes kësaj synohet të arrihet kontrolli dhe menaxhimi më efektiv i burimeve natyrore, duke ruajtur njëkohësisht rolin e shtetit si pronar. Struktura e kompanisë do të përbëhet nga asamble aksionarësh, këshill mbikëqyrës dhe administrator. Kompania do të raportojë financiarisht dhe do të jetë subjekt i auditimit të pavarur.

Sipas relacionit që shoqëron draftin qeveria synon të balancojë interesin publik me eficiencën ekonomike, duke kthyer sektorin pyjor nga një aset i nënshfrytëzuar në një kontribues të drejtpërdrejtë për zhvillimin rural dhe ekonominë e vendit.

Sektori pyjor i Shqipërisë mbulon rreth 40 për qind të sipërfaqes së vendit dhe përbën një aset jo vetëm për prodhimin e drurit, por edhe për biodiversitetin, turizmin dhe shërbimet e lidhura me këtë sektor.

Relacioni nënvizon se projektligji pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin rural, duke krijuar mundësi të reja punësimi dhe duke nxitur aktivitete ekonomike në zonat pyjore.

“Monitor”



te ullirit, ai u shpreh se në të kaluarën kanë përfituar mbi 60 mijë subjekte nga kjo skemë, një shifër që sipas tij nuk përputhet me strukturën reale të prodhimit bujqësor.

Kryeministri theksoi se

reshin nga pronarë formalë të tokës, ndërsa fermerët që e punonin atë mbeteshin pa mbështetje reale.

Rama nënvizoi se skema e mëparshme nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e pro-

bëri të ditur se në Berat do të krijohet një pikë promovimi për këtë produkt, e konceptuar si një eksperiencë për vizitorët, si dhe një laborator ekselence për vlerësimin e cilësisë. Sipas tij, rritja e vlerës së shtuar kërkon

UNIDO

UNIDO dhe Zvicra mbështesin ISUV me ekspertizë ndërkombëtare për rritje të besueshmërisë në diagnostikën fitosanitare në Shqipëri

(Vijon nga faqja 3)

mënyrë të thelluar mbi procesin e identifikimit dhe konfirmimit të disa dëmtuesve me rëndësi të lartë fitosanitare.

Gjatë fazës morfologjike, stafi i ISUV punoi mbi identifikimin e karakteristikave kryesore diagnostikuese të disa insekteve me rëndësi të lartë fitosanitare, si *Bactrocera zonata*, *Rhagoletis pomonella* dhe *Popillia japonica*. Në vijim, faza molekulare ndihmoi në forcimin e kapaciteteve

për përdorimin e teknikave laboratorike që mbështesin konfirmimin më të saktë të identitetit të organizmave të analizuar, duke e bërë procesin diagnostik më të plotë dhe më të besueshëm.

Përtej aspektit teknik të identifikimit, trajnimi ka ndihmuar edhe në përmirësimin e organizimit të punës në laborator, në forcimin e gjurmueshmërisë së mostrave, në dokumentimin më të strukturuar të analizave dhe në kuptimin më të qartë të lidhjes ndërmjet diagnostikës morfologjike dhe konfirmimit molekular. Një vlerë e shtuar e këtij aktiviteti ka qenë edhe puna konkrete mbi listat kontrolluese, fletët e punës dhe qasjet procedurale që ndihmojnë laboratorin të standardizojë analizat dhe të krijojë një bazë më të fortë



për validim dhe përgatitje të mëtejshme drejt akreditimit.

Një investim afatgjatë për bujqësinë shqiptare

Edhe pse këto ndërhyrje janë zhvilluar në laborator, ndikimi i tyre shkon shumë më tej se vetë ambienti laboratorik. Forcimi i kapaciteteve të ISUV në diagnostikën fitosanitare ka rëndësi të drejtpërdrejtë për mënyrën se si vendi zbulon, konfirmon dhe menaxhon rreziqet që prekin kulturat bujqësore, si organizon survejancën, si dokumenton rezultatet dhe si ndërton besueshmëri teknike në sistemin e kontrollit.

Në një kontekst ku kërkesat për siguri, gjurmueshmëri dhe përputhshmëri po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, forcimi i diagnostikës fitosanitare merr vlerë që shkon përtej laboratorit. Ai lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e prodhimit vendas, me rritjen e besueshmërisë së kontrollit zyrtar dhe me përgatitjen graduale të sistemit për t'u përgjigjur më mirë kërkesave që lidhen me sigurinë e prodhimit, tregtimin dhe afrimin me standardet europiane.

Pikërisht kjo është vlera reale e kësaj mbështetjeje: jo thjesht zhvillimi i njohurive laboratorike, por forcimi i një

hallke kyçe për mbrojtjen afatgjatë të bujqësisë shqiptare. Mbështetja e ofruar nga UNIDO përmes Programit



Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), me mbështetjen e Qeverisë Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), nuk përfaqëson fundin e një procesi, por një hap të rëndësishëm në një rrugë më të gjatë forcimi institucional. Trajnimet e zhvilluara kanë ndihmuar në rritjen e njohurive dhe aftësive teknike të stafit, në përmirësimin e praktikave laboratorike dhe në identifikimin më të qartë të nevojave që mbeten për t'u adresuar në të ardhmen.

Ky është një investim me rëndësi afatgjatë për bujqësinë shqiptare. Sepse mbrojtja e prodhimit nuk varet vetëm nga inputet, teknologjia apo rendimenti. Ajo varet gjithashtu nga aftësia për të zbuluar në kohë rrezikun, për ta konfirmuar atë me prova laboratorike të besueshme dhe për të ndërtuar vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Në këtë kuptim, forcimi i diagnostikës fitosanitare është shumë më tepër sesa një çështje laboratorike. Është një investim në sigurinë e prodhimit, mbrojtjen e fermerit dhe qëndrueshmërinë e bujqësisë shqiptare.

Drafti për cilësinë e ajrit, qytetarët do kompensohen kur provojnë dëmin e shkaktuar në shëndet

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar i nxjerrë për konsultim publik nga Ministria e Mjedisit parashikon që qytetarët të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmet në shëndet, në rastet kur provohet se ato janë shkaktuar nga shkëlqetë të autoriteteve në menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Mekanizmi ligjor i propozuar parashikon një lidhje të drejtpërdrejtë të ndotjes së ajrit dhe kompensimit financiar të shtetit.

Neni i ri 19/1 shënon një ndryshim të rëndësishëm në ligjin ekzistues nr. 162/2014, duke kaluar nga një qasje kryesisht rregullatore drejt një modeli që përfshin edhe përgjegjësi civile. Sipas draftit, çdo person që ka pësuar dëmim të shëndetit si pasojë e një shkëlqetë serioze, qoftë me dashje apo nga pakujdesia mund të kërkojë dëmshpërblim, nëse vërtetohet lidhja e drejtpërdrejtë mes ndotjes dhe dëmit.

Qytetarët kanë deri në tre vite kohë për të paraqitur kërkesën nga momenti kur marrin dijeni për dëmin, ndërsa një kufi maksimal prej 10 vitesh vendoset nga momenti i shkëlqetës.

Kjo risi duket se vjen në kuadër të përafritimit të ligjit me direktivat e BE ku lidhja mes ndotjes dhe përgjegjësisë publike ka një theks të fortë.

Përtej kësaj, projektligji sjell

një paketë më të gjerë reformash që synojnë modernizimin e sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të ndotjes. Drafti zgjeron listën e ndotësve dhe përkufizimeve teknike, duke përfshirë elementë si grimcat ultrafine dhe karboni i zi, si dhe fut konceptin e “modelimit të cilësisë së ajrit” për analiza më të avancuara.

Në nivel praktik, parashikohet ngritja e të paktën dy superstacioneve të monitorimit në zona urbane dhe rurale për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave. Këto do të plotësohen nga një sistem i integruar digjital, ku të gjitha të dhënat mbi cilësinë e ajrit do të përpunohen dhe publikohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Projektligji gjithashtu forcon detyrimet për hartimin e planeve të cilësisë së ajrit. Institucionet përgjegjëse do të kenë afate më të shkurtra për reagim në rast tejkalimi të normave dhe do të duhet të garantojnë

që periudhat e ndotjes të kufizohen maksimalisht. Në raste emergjente, njësitë vendore do të detyrohen të zbatojnë plane afatshkurtra, që mund të përfshijnë kufizime të trafikut apo masa të tjera të menjëhershme.

Një tjetër aspekt është rritja e transparencës. Indeksi i cilësisë së ajrit do të përditësohet çdo orë dhe qytetarët do të informohen jo vetëm për nivelet e ndotjes, por edhe për efektet në shëndet dhe masat mbrojtëse.

Drafti synon të krijojë një sistem ku informacioni është i aksesueshëm në kohë reale dhe i përdorshëm për vendimmarrje individuale. Në një aspekt më të gjerë, projektligji adreson edhe ndotjen ndërkufitare, duke kërkuar identifikimin e zonave të prekura dhe bashkëpunim me vendet fqinje për monitorim dhe shkëmbim të dhënash. Nëse miratohet, ligji do të kërkojë miratimin e një sërë aktesh nënligjore brenda 18 muajve.

“Monitor”



Ministri Salla në Kavajë: Shqipëria nis eksportin e vezëve “Kategoria A”, pas dakordësimit me BE

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë një vizite në një pulari në Kavajë, bëri të ditur se Shqipëria ka nisur eksportin e vezëve të “Kategorisë A”, pas

dhe mirëqenies së kafshëve.

Salla u shpreh se tashmë prodhuesit shqiptarë kanë mundësi reale për të hyrë në tregjet ndërkombëtare, duke eksportuar produkte cilësore

Shqipërisë në tregjet e huaja.

Vizita në fermën “Veza Savio” në Kavajë, e themeluar nga dy mjekë veterinarë, Sandri dhe Viola, u konsiderua si një shembull konkret i zhvillimit sipas standardeve të Bashkimit Europian.

Ferma, e cila nisi në vitin 2018 me rreth 12,000 shpendë dhe sot ka arritur në 40,000, operon me cikël të mbyllur prodhimi, duke garantuar kontroll të plotë të çdo hallke dhe produkte cilësore për konsumatorin.

Nisja e eksportit të vezëve të “Kategorisë A” u përshëndet edhe nga Kryeministri Edi Rama, i cili e cilësoi si një arritje të rëndësishme për bujqësinë shqiptare dhe një dëshmi të qartë se vendi po ecën me hapa konkretë drejt integritetit europian.

Rama theksoi se eksporti i vezëve të “Kategorisë A” është një tregues i përkushtimit të Shqipërisë për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të rritur rolin e saj në tregjet ndërkombëtare.



dakordësimit me Bashkimin Europian.

Ai theksoi se ky është një hap i rëndësishëm për sektorin e shpendarisë dhe për rritjen e eksporteve bujqësore, duke u bazuar në përmbushjen e standardeve më të larta të sigurisë ushqimore, gjurmueshmërisë

që plotësojnë kriteret e BE-së.

Ai njoftoi gjithashtu hapjen e aplikimeve për mbështetje financiare nga AZHBR, duke ftuar fermerët dhe sipërmarrësit të aplikojnë për skemat mbështetëse që synojnë rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe forcimin e konkurrencës në

Fond 100 mln lekë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Këshilli i ministrave ka miratuar disa vendime për sektorin e ekonomisë në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe vendimin me rregulloren e re për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Këshilli i ministrave miratoi gjithashtu edhe projektligjin për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital.

“Ky ligj krijon kushtet për të pasur një siguri të të dhënave më të lartë, për të krijuar

integritetit europian. Ne përmbyllim të gjitha piketat, pra kjo ishte piketa përmbyllëse e kapitullit 30. Njëpërmjet aktit që sapo u miratua dhe njëpërmjet një mekanizmi të një bordi të drejtuar nga Ministri i Ekonomisë, një bord ndërmirator, ne do të shqyrtojmë të gjithë investimet të cilat vijnë nga vende jo anëtare të Bashkimit Europian, fillimisht në dy fusha, në fushën e medias dhe në në fushën e mbrojtjes dhe më pas me arsimit në Bashkimin Europian. Ky bord do të do të shqyrtojë të gjitha kërkesat për investime të huaja në të gjithë sektorët kritik të ekonomisë shqiptare”, deklaroi Ibrahimaj.

Këshilli i Ministrave ka miratuar edhe rregulloren e re për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Pas përfundimit të mbledhjes ministri i shtetit për Pushetin Vendor Ervin Demo tha se rregullorja do të sjellë risi për unifikimin e praktikave në nivel kombëtar, dhe ka specifika të caktuara ku bashkitë do të përdorin.

Kjo do të krijojë një platformë të re për menaxhimin e hapësirave publike ku aktorët kryesorë për formalizimin e kësaj rregullore kanë qene vetë bashkitë.

“Monitor”



Pas përfundimit të mbledhjes, në daljen për mediat Ministria e Ekonomisë Delina Ibrahimaj tha se në mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme qeveria ka miratuar vendimin për një fond prej 100 milionë lekë i akorduar për AIDA.

“Njëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave ne miratojmë një fond prej 100 milionë lekë, i cili do të akordohet për AIDA-n, për mbështetjen e sipërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme”.

portofolin e identitetit dixhital, i cili është parakusht dhe përmbyll në mënyrë të përhershme çështjen e shkresave apo të dokumentave elektronike. Me miratimin e këtij ligji dhe me hyrjen në fuqi të tij ne mund të themi se në një kohë afatmesme, do të eliminojmë të gjithë dokumentat shkresore dhe të gjithë firmat shkresore dhe administrata shqiptare do të mund të punojë “paperless”.

Akti i dytë i cili u miratua lidhet gjithashtu me procesin e

Afta Epizootike në Greqi, Shërbimi Veterinar në Gjirokastrë shton kontrollin në territor

Rreziku i përhapjes së sëmundjes së Aftës Epizootike në vendet fqinje ka vënë lëvizje edhe Shërbimin Veterinar në Gjirokastrë. Pas konfirmimit të rasteve në Greqi, institucionet përgjegjëse kanë shtuar kontrollin dhe masat parandaluese në terren.

Sipas veterinerit pranë Agjencisë së Bujqësisë në Gjirokastrë, Krenar Veliu monitorimi i fermave dhe i tregtimit të produkteve blegto-

rale është intensifikuar, ndërsa është kërkuar bashkëpunim maksimal nga fermerët dhe subjektet tregtare për të parandaluar çdo rast të mundshëm infektimi.

“Është një sëmundje që prek kryesisht lopët, delet, dhitë dhe derrat dhe është një sëmundje që shkakton dëm ekonomik”, u shpreh veterineri.

Qarku i Gjirokastrës, numëron 220 mijë të imta dhe rreth 11 mijë gjedhë, special-

istet apelojnë që çdo shenjë e dyshimtë tek bagëtitë të raportohet menjëherë.

“Qoftë krerët që vijnë nga jashtë apo dhe ato vendase duhet të mbajnë kontakt me veterinerin më të afërt për të paraqitur tek ata të gjitha shqetësimet”, tha ai.

Qëllimi mbetet mbajtja nën kontroll e situatës dhe parandalimi i përhapjes së sëmundjes në territorin e qarkut.

Bujqësia po plaket - Sektori agrar nuk po tërheq të rinjtë, bilanci negativ vijon prej vitit 2021

Bujqësia që prej vitit 2021 nuk po e ndryshon bilancin negativ. Edhe në tremujorin e katërt të 2025 kontributi i fermerëve për TAB1 PBB shënoi një rënie me -0.27 %.

Sipas ekspertëve, punët e tokës dhe të blegtorisë nuk janë tërheqëse për të rinjtë shqiptarë; braktisja e zonave rurale ka ndikuar që bujqësia të arkëtojë më pak të ardhura në buxhetin e shtetit.

Që sektori agrar duket se është tërheqës vetëm për moshën e tretë, është detyrë

e Ministrisë së Bujqësisë të hartojë politika joshëse për të kthyer në vendlindje të rinjtë që braktisën tokën e të parëve.

Ekspertja e ekonomisë, Romina Radonshiqi thotë: “Bujqësia është një sektor i nënfinancuar, ndërkohë që ekonomia shqiptare po tregon bilanc pozitiv vetëm në sektorin e turizmit dhe ndërtimit”.

Vepërimitaria bujqësore mund të japë kontribut financiar më tepër se kaq në ekonominë shqiptare, dhe kjo bëhet duke financuar e mbrojtur më tepër

prodhimin vendas.

“Zhvillimi i bujqësisë dihet të jetë një nga objektivat kryesore, sepse bujqësia do të ndikojë në një rritje ekonomike të qëndrueshme, duke rritur numrin e të punësuarve, në rritje të eksporteve, pra duke rregulluar kështu bilancin tregtar”, shton Radonshiqi.

Për herë të parë në Skemën Kombëtare, Ministria e Bujqësisë do të japë 10 mijë euro për çdo të ri që do të zhvillojë aktivitetin e tij blegtoral në zonat rurale.

INVESTIME

Nga emigracioni në agroturizëm, Reçi: Kthehuni në Shqipëri, i keni të gjitha mundësitë

Pas disa vitesh që kaloi në Greqi, Esat Reçi vendosi të rikthehej në vendlindjen e tij, në Kurbin. Dikur i angazhuar në sektorin e ndërtimit, sot ai është një nga shembujt e sipërmarrësve që po investojnë në agroturizëm, duke e kthyer shtëpinë e trashëguar nga gjyshërit në bujtinën që sot po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë.

E vendosur mes kodrave të gjelbra të Kurbinut, agroturizmi "Lahuta e Vjetër" përfaqëson një investim të kurrar me finesë në çdo detaj, nga arkitektura tradicionale e ndërtesës deri te kuzhina autentike. Sot, ai është shndërruar në një destinacion tërheqës dhe mikpritës për turistët vendas dhe të huaj, që kërkojnë të përjetojnë natyrën, traditën dhe shijet e vërteta shqiptare.

Esati tregon se, vendimi për tu rikthyer dhe për të ndërmarrë këtë investim nuk ishte i lehtë. "Por ajo që më shtyu ishte mënyra e jetesës dhe potenciali që ka vendi im. Këtu kam gjithçka: natyrën, traditën dhe mundësinë për të ndërtuar diçka autentike", tha ai.

Përpara se të hidhte hapat e parë, ai kaloi disa vite duke studiuar modele të suksesshme agroturizmi, veçanërisht në rajonin e Toskanës në Itali, për të ndërtuar një koncept të qëndrueshëm dhe autentik.

Hapat e parë ishin vreshtat me fidanët autoktonë dhe krijimin e një kantine për pro-

dhimin e verës dhe rakisë, produkte që sot janë të certifikuara në treg. Projekti u zgje-

jetën rurale përmes gatimeve tradicionale si flija e përgatitur në saç apo djathi i shtëpisë,

munguar. Sigurimi i financimeve dhe përmirësimi i infrastrukturës kanë qenë ndër

ntohet nga turistë nga rvende të ndryshme të Evropës, Rajonit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Izraeli. Shumë prej tyre e kanë zbuluar këtë destinacion përmes rrjeteve sociale, ku përshtypjet pozitive kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e vizitave.

Një koment i një turisteje angleze, e cila e përshkroi agroturizmin "Lahuta e Vjetër" "mikpritja që më la pa mend", u bë pikënisje për një fluks të ri vizitorësh nga Mbretëria e Bashkuar, tregon Esati. Ndërkohë, një pjesë e mirë e turistëve vendas dhe të huaj janë kthyer në mysafirë të përherëshëm të agroturizmit të tij, duke iu rikthyer vazhdimisht përvojën unike që ofrohet aty.

Esati thotë se, "Lahuta e vjetër" është agroturizmi i parë në zonën e Kurbinut. Për të ndërtuar këtë strukturë agroturistike ka qenë lodhje e përpjekje e madhe disa vjeçare. Kam qenë ndër emigrantët e parë dhe kam vendosur të kthehem në Shqipëri dhe të punoj në atdheun tim. Nuk është e vështirë për të punuar në Shqipëri. Nuk është më i lehtë kurbeti, emigracioni, je këtu në vendin tënd punohet këtu jetohe këtu. Po të mos punojmë si turistë në Shqipëri, të punojmë

si kurse punojmë jashtë vendit. Kthehuni në Shqipëri se të gjithë të mirat keni", tha Reçi.

Ndërkohë, investimi vijon të zgjerohet me ngritjen e një kompleksi blegtoral për të imtat, duke synuar forcimin e mëtejshëm të ciklit të mbjellur të prodhimit bio dhe të shërbimeve turistike. Paralelisht, Esati ka angazhuar edhe fermerët e zonës, duke mbledhur prej tyre një gamë të gjerë produktesh vendase, si mjaltë, vezë, qumësht, gliko dhe produkte të tjera tradicionale, duke krijuar kështu një rrjet bashkëpunimi që mbështet ekonominë lokale.

Historia e Esat Reçit nuk është një rast i izoluar. Në shumë zona të Shqipërisë, gjithnjë e më shumë familje po kthehen drejt agroturizmit si një mundësi reale për zhvillim ekonomik dhe social. Ky sektor, i mbështetur nga politikat e qeverisë që prej vitit 2018, po gjeneron punësim, po rrit të ardhurat dhe po kontribuon në rigjallërimin e jetës rurale.

Për Esatin, kthimi në fshat nuk është thjesht një investim ekonomik, por një mënyrë jetese. Ai beson se vlera e vërtetë qëndron në krijimin e diçkaje autentike që i shërben jo vetëm familjes së tij, por edhe komunitetit përreth.

Historia e tij dëshmon se rikthimi në rrënjë mund të shndërrohet në një hap të sigurt drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.



rua duke përfshirë akomodimin dhe shërbimet e restorantit, duke krijuar një cikël të mbjellur që lidh prodhimin bujqësor me turizmin.

Sot, në vitin e tretë të aktivitetit, "Lahuta e Vjetër" ofron më shumë se një qëndrim të thjeshtë. Vizitorët përjetojnë

ndërsa mund të marrin pjesë në aktivitete të përditshme si mbledhja e produkteve në sera, kujdesi për bagëtitë apo shëtitjet në natyrë. Ambientet janë të përshtatura për familje dhe grupe që kërkojnë qetësi larg ritmit të qytetit.

Megjithatë, sfidat nuk kanë

pengesat kryesore. Esati thekson se mbështetja nga skemat e financimit dhe kredia e buta përmes Garancisë Sovrane të qeverisë, kanë qenë vendimtare për vijimin e investimit, ndërsa promovimi ka kërkuar kohë dhe përkushtim të vazhdueshëm.

Sot, agroturizmi i tij frekue-



Domatet janë produkti më popullore në vendin tonë, më të kultivuarat në serra dhe në kopshtet familjare dhe të përdorura në recetat amvisave, por këto ditë çmimi i tyre në tregjet e pakicës ka shënuar rekorde 350-440 lekë për kg për domaten normale dhe 700-800 lekë për kilogram, për domaten qershi një vlerë e panjohur më parë për konsumatorët.

Edhe pse kjo zarzavate nuk është në kohën e saj, sezoni i dytë i serave e sillte këtë produkt me çmime të pranueshme në tezgja në fillim prilli. madje edhe në janar, domatja e vendit kushtonte 170 lek/kg dhe ajo e importi 270-300 lek/kg. Tani dhe domatja evendit ka arritur importin.

Një kombinim faktorësh që nis me sipërfaqet më të ulëta të mbjelljes, dëmet që krijuan përmbytjet në fillim vit dhe kërkesa e lartë në eksport po mban çmimet në tavan.

Të dhënat nga tregu dhe Portali i Fermerëve tregojnë

Ankohemi për naftën, por ka mbërritur dhe kriza e domates, kalon 400 lekë/kg

se dje një kilogram domate me shumicë në fermë kushtoi 170-270 lekë, ndërsa në tezgja domatja e është shndërruar në një produkt "mos me prek".

Të dhënat më të fundit nga monitorimi i tregjeve të shumicës në vend nga Portali i Fermerit tregojnë se çmimi i domates ka pësuar një kërcim të fortë, duke u tregtuar në vlera që i kalojnë 250 lekë për kilogram në disa prej rajoneve kryesore si Tirana, ndërsa në Korçë shumica arrin deri në 300 lekë për kilogram.

Çmimet e larta në pikat e grumbullimit po përkthehen në shifra akoma më rënduese për qytetarët në tregjet e pakicës, ku çmimi për kilogram ka nisur tashmë nga niveli i 350 lekëve, ndërsa varietetet specifike si domatet qershi kapin vlera re-

kord që shkojnë deri në 800 lekë për kilogram.

Ky trend rritës konfirmohet edhe nga analiza historike e shifrave të INSTAT, ku krahasimi i muajve shkurt ndër vite tregon se viti 2026 shënon nivelin më të lartë të çmimit mesatar në katër vitet e fundit, duke lënë pas edhe kulmin e regjistruar në vitin 2023.

Edhe pse në qytete si Tirana dhe Fieri çmimet në pikat e shumicës nisin nga 170 deri në 230 lekë për kategoritë e dyta, reflektimi i menjëhershëm në dyqanet e lagjeve dhe tregjet e vogla po e bën domaten një artikull shumë të shtrenjtë, në një kohë ku konsumi i saj është pjesë e pandashme të recetave të amvisave dhe restoranteve.

Vitin e kaluar një kilogram domate në këtë periudhë u shit

në fermë 80-100 lekë për kg dhe 150 lekë në tezgja, por këtë vit çmimet janë më rritur me shumë se dyfish.

Çmimet e larta të domateve e kanë sjellë një krizë të çmimit të këtij produkti në të gjithë Mesdheun. Ndryshimet klimatike kanë sjellë një paqëndrueshmëri të temperaturave dhe përmbytjet e shkurtit dëmtojnë qindra mijë hektarë sera në Itali, Spanjë, Turqi dhe Shqipëri që janë prodhuesit kryesor të këtij produkti në Europë aktualisht.

Serat e specializuara për eksport në Fier, Lushnjë dhe Berat u përmbytën katër herë nga nëntori 2025 në shkurt 2026, duke humbur krejtësisht një pjesë të madhe të prodhimit dhe fidanishteve të reja.

Uji i tepërt në sera shkak-

toi kalbje, duke çuar në humbjen totale të mbjelljeve të para, ndërsa lagështia e lartë pas përmbytjeve po favorizon përhapjen e sëmundjeve si vrugu, gjë që kërkon investime shtesë në pesticide të shtrenjta, duke rritur kostot për kilogram në fermë, pohoi Mariglen Ziu një fermer më përvojë në kultivimin të perimeve në sera në Dimal.

Faktorë të tjerë që diktojnë rritjen janë e kostot e larta të inputeve bujqësore, ku plehurat kimike, pesticidet dhe veçanërisht kanë pësuar rritje të ndjeshme. Po ashtu, mungesa e fuqisë punëtore në zonat rurale ka detyruar fermerët të rrisin pagat ditore, kosto kjo që transferohet drejtpërdrejt në çmimin final të produktit.

Shumë fermerë, për shkak

të humbjeve nga përmbytjet kanë braktisur punën. Prodhimi i mbetur po orientohet drejt eksportit, ku kërkesa e lartë nga tregjet e rajonit dhe Bashkimit Evropian bën që prodhimi i mbetur për tregun vendas të jetë më i pakët dhe më i shtrenjtë.

Veç të tjerash qeveria shqiptare nuk jep subvencione për fermerët për të amortizuar kostot, ndryshe nga rajoni i Mesdheut që ka më shumë masa mbrojtëse dhe ndihma financiare për bujqësinë.

Ndërsa vendet e tjera të Mesdheut u përballen me të njëjtat sfida klimatike, ato kanë sisteme kullimi dhe mbrojtjeje më të avancuara. Përmbytjet dhe faktorët e tjerë klimatikë në Shqipëri godasin më rëndë për shkak të infrastrukturës së vjetër të kanaleve kulluese, duke e bërë prodhimin vendas më "vulnerabel" dhe çmimin më të paqëndrueshëm krahasuar me fqinjët.

"Monitor"

Ligji për Gjuetinë në fokus të Këshillit Kombëtar të Faunës - Hapa konkretë për ta bërë efektiv dhe të zbatueshëm

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Kombëtar të Faunës u vendos në fokus zbatimi i Ligjit për Gjuetinë, duke u diskutuar hapat konkretë për ta bërë atë efektiv dhe të zbatueshëm në terren.

Gjatë takimit, ku morën pjesë përfaqësues të shoqatave të mjedisit dhe të gjuetarëve, si edhe ekspertë të Ministrisë së Mjedisit, u trajtuan çështje kyçe që lidhen me hartimin e akteve nënligjore dhe Programin Kombëtar të Zhvillimit të Gjuetisë. Diskutimet u përqendruan gjithashtu në menaxhimin e zonave të gjuetisë dhe në krijimin e një sistemi tarifash transparent dhe të drejtë.

Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë iu kushtua edhe periudhës së moratoriumit të gjuetisë, i cili ka shërbyer si një masë e rëndësishme për mbrojtjen dhe rikuperimin e faunës së egër në vend. Të dhënat e mbledhura gjatë kësaj periudhe po shërbejnë si bazë për hartimin e politikave të reja dhe për një qasje më të kontrolluar ndaj aktivitetit të gjuetisë në të ardhmen.

Një element i rëndësishëm në vendimmar-

rje është edhe censi i fundit i shpendëve, i cili ofron një panoramë më të qartë mbi gjendjen e popullatave të tyre. Rezultatet paraprake tregojnë nevojën për kujdes të shtuar dhe menaxhim të qëndrueshëm, duke orientuar institucionet drejt vendimeve të bazuara në të dhëna shkencore.

Rol të rëndësishëm në këtë proces pritet të luajnë bashkitë dhe federatat e gjuetarëve, të cilat do të jenë aktorë kyç në menaxhimin e qëndrueshëm të faunës së egër. Në bashkëpunim me ekspertizën shkencore, ato do të kontribuojnë edhe në përgatitjen e listës së llojeve që do të jenë objekt gjuetie.

Ky proces synon të forcojë kontrollin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve naty-

rore, duke garantuar një balancë mes mbrojtjes së biodiversitetit dhe zhvillimit të aktivitetit të gjuetisë në vend.

Në këtë kuadër, u diskutua edhe mbi periudhën e moratoriumit të gjuetisë, i cili ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm për rikuperimin e popullatave të faunës së egër dhe forcimin e kontrollit në terren.

Një referencë e rëndësishme për vendimarrjen, mbeten edhe të dhënat më të fundit nga Censi i shpendëve ujqorë dimëruar, i zhvilluar në datat 17-18 janar 2026 në 34 ligatina të vendit. Ky proces monitorimi, i realizuar me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe institucioneve përgjegjëse, shërbeu për vlerësimin shkencor të gjendjes së popullatave të shpendëve dhe orientimin e politikave të menaxhimit.

Të dhënat ndër vite tregojnë se, ndonëse Shqipëria mbetet një habitat i rëndësishëm për dhjetëra lloje shpendësh ujqorë, në disa zona janë evidentuar luhajtje dhe ulje të numrit të individëve, duke theksuar nevojën për masa të kujdesshme dhe të qëndrueshme.



FOKUS – FAO: Rriten çmimet e ushqimeve, të nxitura nga kostot e energjisë

Çmimet e ushqimeve u rritën në mars për të dytin muaj radhazi, të nxitura nga kostot në rritje të energjisë të lidhura me luftën në Lindjen

ekonomisti i FAO-s, Maximo Torero, i cituar në një njoftim për shtyp.

“Por, nëse konflikti zgjat përtej 40 ditëve, me kosto të

kostoja e gazit të nevojshëm për prodhimin e tyre.

Në mënyrë specifike, Indeksi i Çmimeve të Drithërave i FAO-s u rrit me 1,5% në mars, nga muaji në muaj.

Rritja ishte veçanërisht e theksuar për grurin (+4,3%), për shkak të korrjeve të SHBA-së që mund të preken nga thatësira dhe mbjelljeve të reduktuara potencialisht në Australi si rezultat i kostove më të larta të plehrave.

Çmimet e misrit u rikthyen pak, të mbështetura nga shqetësimet në lidhje me plehrat dhe vendimet kombëtare për të promovuar biokarburantet, por të zbutura nga një furnizim i fortë global.

Nga ana tjetër, indeksi i orizit ra me 3%, për shkak të kërkesës më të ulët.

Indeksi i vajit vegjetal u rrit me 5,1%, me çmimet në rritje të naftës që sugjerojnë rritje të kërkesës për biokarburante.

Çmimet e sheqerit ndoqën një trend të ngjashëm, duke u rritur me 7,2%, pasi tregjet parashikuan që Brazili, eksportuesi kryesor në botë, do të rriste prodhimin e tij të etanolit. Megjithatë, furnizimi global mbetet i bollshëm, me korrje të mira në Indi dhe Tajlandë.

Indeksi i mishit u rrit me 1%, me çmimet e mishit të derit të nxitura nga kërkesa në BE dhe çmimet e mishit të vëçit të mbështetura nga furnizimi më i ulët, veçanërisht në Brazil.

larta të inputeve dhe marzhe të ulëta aktuale të fermerëve, ata do të duhet të zgjedhin: të kultivojnë të njëjtat kultura me më pak inpute, të mbjellin më pak ose të kalojnë në kultura që kërkojnë më pak plehra. Këto zgjedhje do të ndikojnë në rendimentet dhe do të përcaktojnë furnizimin me ushqime dhe çmimet e mallrave bujqësore për pjesën tjetër të këtij viti dhe gjatë gjithë vitit të ardhshëm”, paralajmëron ai.

Konflikti në Lindjen e Mesme ka rritur çmimet e plehrave, 30% e të cilave kalojnë tranzit nëpër Ngushticën e Hormuzit, dhe çmimi i të cilave ndikohet gjithashtu nga



e Mesme, por të kompensuar nga furnizimet e bollshme me drithëra, raportoi sot Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO).

Indeksi i Çmimeve të Ushqimeve të FAO-s, i cili gjurmon ndryshimet në çmimet ndërkombëtare për një gamë mallrash, u rrit me 2,4% nga muaji në muaj dhe 1% krahasuar me marsin 2025.

“Rritjet e çmimeve që nga fillimi i konfliktit kanë qenë modeste, të nxitura kryesisht nga çmimet më të larta të naftës, por të kompensuar nga një furnizim i bollshëm global me drithëra”, përmbodhi kry-

Politikat Prioritare 2027-2029: 114 projekte strategjike me investime prej 7,38 miliardë euro për zhvillimin e vendit

Qeveria ka miratuar Dokumentin e Politikave Prioritare për periudhën 2027-2029, një udhërrëfyes strategjik që përcakton drejtësit kryesore të politikës shtetërore dhe orienton shpërndarjen e burimeve financiare drejt realizimit të prioritetëve strategjike të vendit.

Ky dokument, i cili shërben si bazë për hartimin e buxhetit afatmesëm, përforcon lidhjen mes planifikimit strategjik dhe menaxhimit të financave publike, duke vendosur një fokus të veçantë tek Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Në këtë listë përfshihen gjithsej 114 projekte investimi, të cilat synojnë të përmirësojnë procesin e propozimit, miratimit dhe implementimit të projekteve strategjike dhe njëkohësisht të adresojnë kërkesat e institucioneve ndërkombëtare financiare dhe partnerëve zhvillimorë.

Totali i fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre projekteve llogaritet 723 miliardë lekë, ose 7,38 miliardë euro, duke përfshirë investime në infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore, energji, zhvillim ekonomik, arsimin, shëndetësinë, mbrojtjen sociale, turizmin dhe mjedisin.

Në fushën e transportit, prioritet ka ndërtimi i bajpaseve dhe aksit rrugor Elbasan-Lekaj, me një vlerë prej 360 milionë euro, rehabilitimi dhe zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës, me vlerë 298,86 milionë euro, si dhe zhvillimi i korridorit Adriatiko-Jonian, ku për segmentin

Poçem-Memaliaj planifikohen 597 milionë euro.

Investime të mëdha janë parashikuar edhe në linjat hekurudhore. Buxheti i planifikuar për linjën Durrës-Prishtinë që konsiderohet projekti më strategjik për më cilin sigurohet lidhja e ekonomive të Shqipërisë dhe Kosovës është 750 milionë euro.

Ndërsa investime janë planifikuar edhe për rehabilitimin e linjës Durrës-Rrogoshinë dhe Tiranë-Durrës. Rehabilitimi i këtyre linjave synon të përmirësojë lidhjet rajonale dhe transportin e mallrave.

Në fushën e energjisë, investimet përfshijnë ndërtimin e impianteve fotovoltaike dhe hidroelektrike, digjitalizimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, ndërtimin e linjave të tensionit të lartë 400 kV për interkoneksionin me Kosovën dhe Greqinë, si dhe projektet për magazinimin nëntokësor të gazit natyror dhe terminalin LNG në Vlorë, me vlerë 120 milionë euro, duke garantuar sigurinë energjetike dhe diversifikimin e burimeve.

Ndër projektet më të mëdha energjetike është ai i HEC-it të Skavicës që lidhet me rrjetin e transmetimit dhe integrimin e kapaciteteve në sistem, me vlerë 800 milionë euro, si dhe ndërtimi i linjës hekurudhore të transportit të gazit natyror, gazsjellësi ALKOGAP, me vlerë 195,5 milionë euro.

Spektori i zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë përfshin projekte në Ekonominë Blu, zonat teknologjike dhe zhvil-

limin e biznesit, duke përfshirë zonën TEDA në Koplik dhe projektet për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor.

Në fushën sociale, arsimin dhe shëndetësinë, prioritet janë rehabilitimi i infrastrukturës për të rinjtë në konflikt me ligjin, ndërtimi i qendrave të rehabilitimit dhe “Shtëpive mbështetëse” për personat me çrregullime mendore, investimet në Spitalin Onkologjik dhe qendra të inovacionit shkencor.

Projekti “Deti Blu” për mjedis të pastër dhe ripërtëritje, përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet dhe rehabilitimi i digave, së bashku me projektet AL-PACT dhe përmirësimin e infrastrukturës ujësjellës kanalizimeve në Tiranë dhe Durrës, janë ndër prioritetet kryesore të sektorit të mjedisit, duke synuar adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Me miratimin e 114 projekteve strategjike, qeveria synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe social, të rrisë efikasitetin institucional dhe transparencën në menaxhimin e financave publike, si dhe të forcojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë.

Dokumenti i Politikave Prioritare 2027-2029 dhe Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare krijojnë një vizion të qartë për të ardhmen, duke siguruar që çdo investim të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në objektivat strategjike dhe sektoriale të vendit.

Kompensimi i TVSH-së për fermerët, si do të llogaritet me autofaturat

Masa e kompensimit të TVSH për fermerët do të llogaritet direkt nëpërmjet vlerës së autofaturave që përpunuesi apo grumbulluesi lëshon ndaj tyre.

Nga 1 janari 2026 ka hyrë në fuqi skema e re e kompensimit të TVSH-së për fermerët, e cila parashikon përfitimin e një kompensimi 10% për prodhimet bujqësore të shitura tek grumbulluesit, përpunuesit ose agroturizmet e certifikuar.

Sipas ndryshimeve ligjore, baza e kompensimit do të jetë autofatura e lëshuar nga subjekti blerës, mbi të cilën llogaritet 10% që i kthehet fermerit.

“Për të sqaruar opinionin publik, po ju marr një shembull. Nëse një fermer nëpërmjet autofaturave faturon 10 milionë lekë do të përfitojë në llogarinë e tij 1 milion lekë”, deklaroi ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Andis Salla.

Qëllimi i kësaj skeme është

të rimburojë TVSH-në 10% që fermeri ka paguar për inputet bujqësore, si plehrat kimike, farat dhe fidanët, duke ulur kostot e prodhimit dhe duke nxitur formalizimin e transaksioneve në sektor.

Prej vitit 2019 deri në dhjetor 2021 TVSH-ja për inputet bujqësore ka qenë zero. Nga 1 janari 2022 pas miratimit të ndryshimeve fiskale hyri në fuqi vendosja e TVSH-së 10% të çmimeve të inputeve bujqësore.

Megjithatë Shoqata e Blegtorëve Prodhues të Qumështit më herët ngriti shqetësimin se rreth 70% e qumështit të shitur te përpunuesit bëhet pa autofaturë.

“Shitja e qumështit deri në 70% ndodh pa fature, pasi autofatura është një abuzim ndaj fermerit që përpunuesi e pret, kur e ku i duhet, sa i duhet me çmimin që i duhet, për të rregulluar bilancin e tij mujor apo vjetor apo për të qenë në

rregull me veten e vet”, deklaroi më herët kryetari i Shoqatës së Blegtorëve Prodhues të Qumështit Gentian Lalaj.

Shoqata e blegtorëve kundër kompensimit të TVSH-së 10% me autofaturë, por me faturim direkt

Deri në vitin 2017, rimbursimi i TVSH-së 20% për fermerin kalonte nëpërmjet përpunuesve çka do të thotë se p.sh. për çdo blerje me faturë tatimore nga fermeri, përpunuesi mund të kreditonte këtë vlerë në TVSH-në e zbritshme. Kjo skemë e bënte ekonomikisht të leverdishme blerjen edhe me çmim të lartë për fermerin dhe siguronte marzh të qëndrueshëm fitimi për industrinë.

Nga viti 2019 deri në 2022, skema ndryshoi. Fillimisht në 2019 TVSH-ja në blerje (nga fermerët) u ul në 6%, ndërsa u hoq plotësisht më 2022.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Shndërrimi i mbetjeve të qelqit në vlerë në Parkun e Ekonomisë Qarkulluese në Fushë-Krujë

Në kuadër të Ditës Botërore të Riciklimit, Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë sjell fakte se si përmes projektit EU for Circular Economy and Livable Cities të BE-së, mbetjet e qelqit në Parkun e Ekonomisë Qarkulluese në Fushë-Krujë po kthehen në materiale filtrues për pishina, duke i dhënë një jetë të dytë afro 40 tonëve qelq

Shndërrimi i mbetjeve të qelqit në vlerë: Si mund ta shërojë natyrën dhe të japë përfitime riciklimi i qelqit

Gati 40 ton mbetje qelqi, dikur të destinuar për në landfill apo të hedhura në natyrë, tashmë riciklohen në material filtri për pishina. Në

teriali i filtrit për pishina po prodhohet në Shqipëri për herë të parë. Deri tani, kompanive i duhej ta importonin nga jashtë.

“Prodhimi vendas jo vetëm që zvogëlon mbetjet, por krijon edhe një mundësi të vlefshme. Ai e mban qelqin larg landfilleve dhe

gamë të gjerë përdorimesh. Ai mund të përdoret në stola dhe karrige, banakë restorantesh dhe baresh, sipërfaqe kuzhine, lavamanë dhe banja, apo praktikisht në çdo hapësirë ku dëshirohet një material i qëndrueshëm dhe vizualisht tërheqës.

Si pjesë e projektit, Parkut të Ekonomisë Qarkulluese i është ofruar mbështetje për të krijuar si infrastrukturën ashtu edhe kuadrin organizativ, duke përfshirë blerjen e pajisjeve të përpunimit të qelqit, trajnimin për praktikën e riciklimit, udhëzimet e ekspertëve dhe promovimin e punës së vazhdueshme. “Riciklimi i Qelqit në Shqipëri” është bërë tani kompania e parë e licencuar në vend e dedikuar ndaj riciklimit dhe përpunimit të qelqit.

Kompanitë në industrinë e dritareve tani kanë qasje në një zgjidhje miqësore me mjedisin për menaxhimin e mbetjeve të tyre të qelqit. Në vend që të paguajnë tarifa të larta për asgjësimin në landfill apo të rrezikojnë hedhjen e tyre në zona të papërshtatshme, ato mund ta ofrojnë këtë material për procesin e riciklimi që e transformon atë në produkte të vlefshme.

Kjo qasje jo vetëm që zvogëlon kostot operative, por kontribuon edhe për një mjedis më të pastër,

mjedisit, ndërsa u ofron kompanive të pishinave një produkt vendas që është më i mirë se rëra e silicit, e cila është alternativa aktuale”, shpjegon ajo.

Përmes ndihmës së programit të mbështetur nga BE-ja, disa kompanive u janë shpërndarë kontejnerë të posaçëm, ku ato hedhin mbetjet e tyre të qelqit. Materiali i mbledhur transportohet më pas në parkun e riciklimit në Fushë-Krujë. Atje, qelqi kontrollon për të përcaktuar nëse duhet pastruar para se të futet në një makinë bluarëse, duke përdorur një ekskavator.

Siç shpjegon Bleona Zela, procesi prodhon grimca në tre madhësi – 1-2 mm, 2-3 mm dhe 3-4 mm – ideale për përdorim në filtrat e pishinave. Produkti i përfunduar paketohet në vend në qese 20 kg, gati për shpërndarje.

Qelqi i mbetur, i ripërdorur në terrazzo për përdorim dekorativ, gjen jetë të re në një

mbështet ekonominë qarkulluese, si dhe rrit reputacionin e kompanive si biznese të qëndrueshme. Duke përdorur këtë alternativë ekologjike, kompanitë e dritareve përfitojnë financiarisht, ndërkohë që kontribuojnë në mënyrë aktive për uljen e ndotjes dhe ruajtjen e burimeve.

Mbetjet e qelqit përbëjnë një kërcënim serioz për mjedisin, veçanërisht kur përzihen me plastikë apo substanca të tjera të rrezikshme.



Parkun e Ekonomisë Qarkulluese RecycAl në Fushë-Krujë, një makineri e instaluar rishtazi përpunon deri në 300 kilogramë qelq në orë, duke e bluar atë në një pluhur të imët që shërben si një mjet efikas për filtrimin e pishinave.

Mbetjet e qelqit nga dritaret, shishet dhe kavanozat tani mund të transformohen në material filtrimi për pishina, përmes një procesi të avancuar që e pastron, e thërrmon dhe e shndërron atë në kokrriza të sigurta. Ky material, përdoret si alternativë në vend të rërës së silicit dhe ofron efikasitet më të lartë filtrimi, duke kapur grimca deri në 5 mikronë, ndërsa ngarkesa e saj e lehtë negative ndihmon për të penguar rritjen e baktereve.

Projekti “Riciklimi i Qelqit në Shqipëri” mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytetet e Jetueshme”, që synon të ofrojë zgjidhje në fazat e hershme përmes parandalimit dhe reduktimit, si dhe zgjidhje në fazat e mëvonshme, siç janë rikuperimi dhe gjurmimi i rrjedhave të materialeve.

“Nisma ‘Riciklimi i Qelqit në Shqipëri’ përqendrohet të mbledhja e mbetjeve të qelqit nga kompanitë industriale dhe transformimin e tyre në dy produkte: material filtri për pishina dhe terrazzo, një material dekorativ”, shpjegon Bleona Zela, Menaxhere e Projektit. Ajo vëren se ma-



Ekonomia e “Paketës së Maleve”, Qeveria shpall zonat me përparësi zhvillimi në 10 bashki të vendit, harta e zonave të reja, nga jugu në veri

Qeveria shqiptare ka hedhur një hap drejt jetësimit të strategjisë për zhvillimin e zonave rurale dhe malore, duke shpallur zyrtarisht dhjetëra zona në territorin e 10 bashkive të vendit si “Zona me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”. Ky vendim, i bazuar në ligjin e ri “Për paketën e maleve”, synon të kthejë territore deri më sot të nënshfrytëzuara në pole të reja të zhvillimit ekonomik, industrial dhe turistik.

Bashkitë që preken nga kjo valë e shpalljeve përfshijnë Berat, Dimalin, Durrësin, Himarën, Kavajën, Librazhdin, Mirditën, Rogozhinën dhe Vlorën.

Tre shtyllat e zhvillimit, ekonomi, industri, turizm

Sipas vendimeve të zbardhura, zonat e shpallura nuk do të jenë thjesht pika në hartë, por hapësira ku do të nxiten tre lloje kryesore aktiviteteve si zhvillimi ekonomik, mbështetje për sipërmarrjet lokale dhe agropërpunimin; zhvillimi industrial, krijimi i kushteve për prodhim dhe përpunim në harmoni me mjedisin; zhvillimi turistik, shfrytëzimi i potencialeve natyrore për turizmin e aventurës, atë rural dhe kulturor.

Harta e zonave të reja, nga jugu në veri

Shtirja e këtyre zonave është e konsiderueshme, duke prekur si fshatra të thellë malorë, ashtu edhe zona kordinore me dalje në det.

Librazhd dhe Mirditë

Këto dy bashki mbajnë peshën kryesore të sipërfaqeve të shpallura, me mbi 50 mijë hektarë në Librazhd (përfshirë Stëblevën, Polis dhe Lunikun) dhe sipërfaqe masive në Mirditë (Fan, Orosh e Rubik), ku turizmi malor dhe industria nxjerrëse pritet të kenë hov të ri.

Himarë dhe Vlorë

Në jug, fokusi mbetet te gërshetimi i detit me malin. Zona si Palasa, Piluri, Kuçi dhe Borshi në Himarë, apo Tragjasi e Dukati në Vlorë, marrin statusin special për të thithur investime në turizëm dhe infrastrukturë.

Durrës, Kavajë dhe Rogozhina

Edhe bregdeti i Shqipërisë së Mesme përfiton nga paketa. Fshtrat e Ishmit e Manzës në Durrës, dhe zonat si Kryevidha e Gosa në Rogozhinë, do të jenë nën lupën e investitorëve për projekte agroturistike dhe ekonomike.

Statistika Kryesore sipas Bashkive:		
Bashkia	Zona të Shpallura	Rajonet Kryesore
Himarë	18 Zona	Palasë, Pilur, Kuç, Borsh, Qeparo
Librazhd	10 Zona	Stëblevë, Hotolisht, Polis, Orenjë
Mirditë	7 Zona	Fan, Orosh, Rubik, Selitë
Durrës	3 Zona	Ishëm, Manzë, Rrashbull
Vlorë	4 Zona	Orikum (Dukat/Tragjas), Shushicë
Berat	44 Zona	Otlak, Velabisht, Sinjë, Roshnik

Jaupaj: Parku Kombëtar i Vjosës, shembull i menaxhimit të lumenjve të egër

Në Ditën Ndërkombëtare të Lumenjve, ministri i Mjedisit Sofjan Jaupaj, përkujtoi 3-vjetorin e shpalljes së Vjosës Park Kombëtar, një arritje të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri dhe në Europë.

“Vjosa është sot i vetmi park kombëtar i një lumi të egër në Europë, një model unik për ruajtjen e kësaj pasurie të jashtëzakonshme për brezat që do të vijin”, deklaroi ministri Jaupaj.

Ai theksoi se shpallja e Vjosës Park Kombëtar përbën një shembull për menaxhimin e lumenjve të egër dhe një kontribut të rëndësishëm për biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Në kuadër të përkujtimit të kësaj dite simbolike, ministri Jaupaj njoftoi hapjen e Qendrës Multifunktionale të Parkut Kombëtar të Vjosës në Përmet, një hapësirë e re e projektuar nga Ministria e Mjedisit.

Qendra do të shërbejë si: një

pikë për informim shkencor mbi ekosistemet e lumit; një pol ekoturistik pranë lumit të fundit të egër në Europë; një hapësirë edukative dhe ndërgjegjësimi për qytetarët dhe turistët mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Ministri Jaupaj theksoi se hapja e Qendrës Multifunktionale është një tjetër hap drejt forcimit të turizmit ekologjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit, duke garantuar që Vjosa të ruhet si një pasuri e jashtëzakonshme natyrore dhe kulturore.



Berat dhe Dimal

Në Qarkun e Beratit, dhjetëra fshatra në Otlak, Velabisht e Sinjë marrin statusin e zonës malore, duke u dhënë përparësi prodhimeve tradicionale dhe turizmit të zonës së mbrojtur të Tomorit.

Zbatimi dhe mbikëqyrja

Për jetësimin e këtyre vendimeve janë ngarkuar një sërë institucioneve, ku peshën kryesore e mban Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadashtës dhe bashkitë përkatëse. Këto institucione duhet të garantojnë që investimet të jenë në përputhje me planet rreguluese dhe të sjellin impakt real në punësimin e banorëve të këtyre zonave.

Ky hap i qeverisë shihet si një përpjekje për të ofruar stimuj për të investuar në “ekonominë e gjelbër” dhe për të kthyer vëmendjen te pasuritë natyrore të brendshme të vendit.

KËNDI I EKSPERTIT

Enver Isufi: Mendimi tredimensional dhe përtej tij, në shkencë, prodhim, letërsi



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

(Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike)

Botën e kanë zhvilluar "Mendja" dhe "Duart". Kështu është realizuar e tëra; nga e thëna deri te e bëra.

Mendimet kanë evoluar si në gjerësi (shumëllojshmëria e dijeve, ideve, teknologjive), ashtu edhe në thellësi, e cila lidhet me qasjen sa më afër më të mirës, sa më afër të përsosurës, sa më pranë të vërtetës shkencore, e cila përfaqëson thellësinë e mendimit dhe të zbatimit.


Mendimi është zhvilluar si nevojë e mbijetesës dhe jetesës së racës njerëzore. Përsosmëria e saj është ndihmuar nga pafundësia e objekteve që na rrethon. Muzika gjithashtu është magjike nga pafundësia e tingujve që na rrethon.

Natyrë është e bukur nga pafundësia e bimëve, kafshëve, luleve, insekteve, pra e gjallesave nga mikroskopikët e deri të kafshët trupmëdha.


Për një rreth më të gjërë lexuesish po paraqesim objektet 3D që na rrethojnë dhe dimensionet që ato përfaqësojnë, për të kaluar pastaj edhe tek mendimi 3D e më shumë dimensione.

Hapësira tredimensionale (3 D), nënkupton hapësirën fizike të një kubi me përmasat e tij: gjatësinë, gjërësinë, thellësinë. Edhe mendimi që duket abstrakt, në fakt ka përmasat e tij fizike në rrokjen e fenomeneve. Sa i gjerë është mendimi ose ideja, sa i gjatë është numri i objekteve që ai përfshin dhe sa i thellë është, pra sa të imta janë detajet që përshkruhen nga mendimi dhe ideja e parashtruar, aq më pranë të vërtetës absolute jemi.

Kalojmë nëpër disa skica e foto të mëposhtme. (Shih Skicën nr. 1)



Skica nr. 1. Paraqet një kub me tre përmasat përkatëse



Skica nr. 2. Dimensionet e katër figurave

Objektet 3 Demisionale (3 D)		
Kubi	Sfera	Koni
Prizëm kuadrat	Cilindër	Piramidë
Prizëm 6 këndësh	Hemisferë	Prizëm tre këndor

Skica nr. 3. Objekte tredimensionale: kubi, sfera, koni, prizmi kuadrat, cilindri, piramida, prizmi gjashtëkëndësh, hemisfera, prizmi këndor

me një sasi të caktuar dimensionesh. (Shih Skicën nr. 5/1)

Persona të tjerë kanë këndvështrim më të gjërë mbi gjallesat e pyllit. Ata nuk i njohin

Skica 1. Tre dimensionet e kubit

Nga literatura mësojmë se zeroja (0) është zero dhe shprehet me zero dimension (0D), viza është një dimensional (1D) katrori është 2 dimensional (2 D) dhe kubi është 3 dimensional (3 D). (Shih Skicën nr. 2)

Më poshtë paraqiten disa objekte tre dimensionale (3 D) (Shih Skicën nr. 3).

Po sjellin disa shembuj të gjërësisë, gjatësisë dhe thellësisë së mendimeve e kategorive të ndryshme njerëzish, duke i ilustruar me objektet konkrete që rrethojnë mjedisin tonë dhe shumë më gjerë. (Shih Skicën nr. 4)


Ka shtresa shoqërore dhe mosha njerëzore, të cilët dinë vetëm rreth fushës së tyre profesionale ose shoqërore, aq sa dinë që dhelpra ha pulat dhe ujku ha delet dhe nuk kanë njohuri rreth zinxhirit ushqimor të kafshëve të pyllit, prandaj kanë një mendim të kufizuar 1-2 dimensionale dhe jo më tepër. (Shih Skicën nr. 5).

Të tjerë persona, njohin marrëdhëniet mes tigrit, drerit dhe barit e bimëve si burim ushqimi, pra njohin një mishngrënë dhe një barngrënë. Këto persona kanë një mendim dy dimensional (2 D)

Njohja e një numri shumë të madh kafshësh dhe bimësh përfaqëson një gjerësi dhe gjatësi të caktuar objektësh,




Skica nr. 4. Dhelpra me pulën dhe ujku me delen



Skica nr. 5. Tigri, dreri, bari



Skica nr. 5/1. Njohja e specieve të shumta gjallesash, por jo ndërthurjet e mardhënieve mes tyre



Skica nr. 6. Ndërthurjen komplekse mes gjallesave (për krahasim edhe në letërsi mes personazheve)

mendimit është prirja për të njohur një send ose fenomen në tërësinë e tij.

Kjo arrihet kur objektit i vijmë rreth e qark plotësisht 360 gradë me sy dhe mendje. Gjykimi kompleks ose holistik lidhet me aftësinë e rrotullimit të trurit në gjithë hapësirën e problemit, pra në 360 gradë. Madje edhe kjo nuk mjafton. Rrotullimi 360 gradë mbi sipërfaqen e sheshtë nuk mjafton. Shembull: Mund të vimë përreth Torrës së Durrësit dhe e zbulojnë se ka apo nuk ka njerëz dhe sa ka, por nëse nuk kontrollojmë edhe brenda Torrës dhe

vetëm fizikisht, por njohin sjelljet e tyre mes gjallesave e tjera, sjelljen e tyre ndaj kushteve ekologjike, vendi që zë secili në këtë ekosistem, hartën botërore të shtrirjes së këtyre gjallesave etj. Pra kanë mendime dhe njohuri mbi tre e më shumë dimensionale për gjallesat e pyllit. (Shih Skicën nr. 6)

Ndërthurjen komplekse mes gjallesave të pyjeve dhe atyre jashtë tyre, rrit edhe dimensionalitetin e mendimeve, këndvështrimeve dhe gjykimeve ndaj këtyre ideve, pra sasia, shoqërohet edhe me thellësinë e informacionit.

Një shembull tjetër mund të ishte leximi thjesht i orës, si matës i kohës, i cili është një mendim 1 dimensional, ndërsa orëndreqësi ka mendim tredimensional mbi ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave të orës dhe ideatorët e prodhimit, artizanal ose industrial të orës si matës së kohës vlerësohen me mendime, multidimensionale.

Të shikosh qindra njerëz në rrugë ose në sheshe, stadume, teatro, mjafton një mendim 1-2 dimensional. Nëse na kërkohet të japim mendim për identitetin e secilit, si për emrat, kombësinë, origjinën, profesionet, etj. na duhet një mendim shumëdimensional.

Vetëm një studim me mekanizmin që ofron censusi i atij grupi njerëzish, ose komuniteti, mund të përftojë një mendim gjithëpërfshirës, pra një mendim shumë më dimensional social-demografik. (Shih Skicën nr. 6/1)

Rrotullimi i mendimit

Koncepti i rrotullimit të

KËNDI I EKSPERTIT


(Vijon nga faqja 11)

Enver Isufi: Mendimi tre dimensional dhe përtej tij, në shkencë, prodhim, letërsi



Skica nr. 6/1. Një grumbull njerëzish të cilët i shohim, por nuk i njohim


Këto shëmbuj priren të na bindin se në veprat tona sado të mira të bukura të jenë, përsosmëria nuk ka kufi. Në këtë rast kur flasim për vepra nuk përfshihen vetëm veprat e artit dhe letërsisë, por shumë e shumë më gjerë. (Shih Skicën nr. 7)



Skica nr. 7. Lëvizja e trurit 360 gradë në vend të sheshtë, lartërsi, thellësi

Në nevojën e rrutollimit të trurit na ndihmon edhe shembulli i biologjisë së fluturave. Shembulli i ciklit jetësor të fluturave, është një fakt që na ndërgjegjëson të rrisin dimensionet e mendimeve tona sipas ciklit të zhvillimit të një fluturë.

Fluturat janë gjallesa shumë interesante, të cilat ndryshojnë plotësisht nga stadi në stad. Larva (krimbi, vemja) e fluturës së një specie nuk ka fare ngjashmëri me fluturën e rritur me ngjyrat e saj të mrekullueshme. Edhe sot e kësaj dite nuk janë zbuluar të gjitha mekanizmat e këtij transformimi magjik. (Shih Skicën nr. 8)



Skica nr. 8. Cikli i zhvillimit të një fluturë ngjason me fenomenet të cilat kudo dhe kurdoherë janë në zhvillim dhe nëse nuk njihet e tëra, nuk e shpjegon dot pjesëzën

mbi taracën e saj, nuk arrijmë të kemi një mendim të plotë mbi praninë reale të njerëzve të Torra.

Në këtë kuptim gjerësia dhe thellësia e mendimit nuk ka kufi, thjesht është një infinit. Për ta konkretizuar mund të sjellim globin, rrotullimin e tij për ta parë në të gjitha dimensionet. Globi vetë ndahet në paralele dhe meridiane për të përshkruar më saktë vendet, klimën, popujt, pyjet kafshët, detërat dhe oqeanet etj., etj.

kësaj larve. Rreth 50 % e fermerëve mund të njohin edhe vezët e kësaj fluturë sepse mund ti kenë parë larvat duke çelur mbi gjethe, por edhe kjo nuk i shkon ndërmend që është kjo fluturë që endet parcelës, e cila i ka lëshuar këto vezë mbi bimën e lakrës.

Një numër i vogël fermerësh mund të njohin fluturën që ka lëshuar këto vezë dhe akoma më pak prej tyre e njohin krizalidën nga e cila ka dalë kjo fluturë, sepse faza e krizalidës ndodh ose në bimë, ose në tokë.


Një numër fare i vogël njerëzish e njohin biologjinë e plotë të kësaj fluturë dëmtuese, të cilët janë vetëm disa agronomë dhe ndonjë fermer i trajnuar. Këto mund të themi që kanë njohuri tredimensionale për insektin në fjalë. Një numër fare, fare i vogël ekspertësh kanë një mendim dhe njohuri komplekse multidimensionale për këtë fluturë dëmtuese në bujqësi. Ata njohin vendin që zë ajo në klasifikimin taksonomik të botës së insekteve, emrin e saj në gjuhën latine, me cilat bimë të tjera ushqehet ajo, sa është e përhapur në territorin e një vendi, cilët janë armiq të saj natyralë, cilat janë insekticidet kimike ose biologjike që japin efekt në vrasjen e larvave të saj dëmtuese në bujqësi, cili është dëmi ekonomik në pjesë të ndryshme të vendit, e madje edhe të bujqësisë botërore. Ky lloj volumi dijes, këto mendime gjithëpërfshirëse i kanë ekspertët entomologë, pra profesionistët e fushës. Kjo kategori profesionistësh ka njohuri, mendime multidimensionale mbi këtë insekt dëmtues në bujqësi.

Njohja e biologjisë së kësaj fluturë do të thotë të "rrotullosh mendimin" në 360 gradë.

Si përfundim theksojmë se mendimet 3 e më shumë dimensionale janë shumë larg mendimeve 1-2 dimensionale. Po ilustruam me skicat e mëposhtme:

Skica e parë paraqet mendimin dhe gjykimin bardh e zi dhe skica e dytë bretkosën në fund të pusit. Skica paragjykimi dhe të menduarit bardh e zi.

Skica paragjykimi dhe të menduarit bardh e zi



skica 9.



Skica 10



Pamja 11, globi

Skica 9 dhe 10 :

Bardhe e Zi-ja, dhe fabulla filozofike kineze e bretkosës në fund të pusit, janë gjykime 1-2 dimensionale.

(Bretkosa mendonte se deti është sa uji i pusit ku ajo notonte dhe qielli ishte sa gryka e pusit që ajo shikonte)

Globi si objekt dhe si koncept rrok mendime e njohuri me shumë e shumë dimensione.

Ndaj përdoret temi "mendim gjithëpërfshirës", "mendim global", ose zgjidhje lokale, kombëtare e globale e problemeve. Përgaditjen e një globi realizohet nga mendime dhe ide në një numër shumë të madh dimensionesh

Mendimi dhe shikimi 3 dhe më shumë dimensional, ka zbatim universal, në shkencë, art dhe letërsi. Si gjen zbatim në letërsi ky koncept mund të përgatitet një tjetër artikull.

Kompensimi i TVSH-së për fermerët, si do të llogaritet me autofaturat

(Vijon nga faqja 7)

Si do të bëhet aplikimi

Kërkesa për aplikimin e kompensimit të TVSH-së do të dorëzohet elektronikisht në tatime. Administrata tatimore parashikon ta finalizojë së shpejti automatizimin e procesit të rimbursimit të fermerëve.

Krahas kërkesës fermeri duhet të dorëzojë edhe autofaturat e lëshuara nga blerësi, në të cilat të jetë i shënuar edhe NIPTI i fermerit, si dhe kërkesa për kompensim

do të paraqitet 2 herë në vit. Brenda datës 31 Dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit përkatës. Brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Korrik-Dhjetor të vitit paraardhës.

Kërkesa do të dërgohet në rrugë postare ose në rrugë elektronike. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Ndërkohë fermeri për përfituar kompensimin, së pari fermeri duhet të jetë i pajisur me numër identifikimi (NIPT)

nga Administrata Tatimore, pa pasur detyrim për deklarim periodik të TVSH-së. Qarkullimi vjetor nuk duhet të tejkalojë kufirin minimal të regjistrimit për TVSH.

Në vend fermerët që shesin produktet e tyre bujqësore/blegtoralë, nuk bëhen automatikisht subjekt i TVSH-së (pra nuk regjistrohen për TVSH) nëse qarkullimi i tyre vjetor është deri në 10 milionë lekë. Nëse qarkullimi kalon 10 milionë lekë, fermeri duhet të regjistrohet si subjekt i TVSH-së (tatimpagues i zakonshëm).

"Monitor"

Çmimet në tregun e fruta-perimeve, me rritjen e naftës konsumatorët po shpenzojnë më shumë në blerje

Rritja e çmimeve të naftës po pason në rritje të çmimeve edhe të produkteve në tregun e fruta-perimeve.

Në qytetin e Korçës, domatja dhe kastravecet janë shtrenjtuar deri në 20%, duke ulur ndjeshëm blerjet e qytetarëve. Produktet bazë të tryezës, si domatja e importuar nga Greqia, kanë arritur çmimin nga 300 deri në 400 lekë për kilogram.

Shumë familje, sidomos pensionistët, po ndiejnë

koston e shtrenjtimit të çmimeve duke reduktuar blerjet. Kjo situatë haset edhe në tregun e Gjirokastroës, pavarësisht se jemi në sezon pranverë.

"Rritjen e çmimeve ne e ndiejmë shumë. Jemi konsumatorë" – u shpreh një prej blerësve.

"Çmimet janë në kulm. Ne pensionistët nuk blejmë dot me këto çmime. Me çfarë ta blejmë domaten që është me 400 lekë të rinj?"

Tregtarët thonë se rritja

